

VENDIM
Nr.359, datë 26.5.2005

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE DHE TË FITUESIT, NË
TENDERIN E HAPUR NDËRKOMBËTAR, PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË
ANONIME “ALBTELECOM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” dhe të nenit 6 të ligjit nr.8810, datë 17.5.2001 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Albtelecom””, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit përfundimtar të vlerësimit të ofertave, paraqitur nga komisioni i vlerësimit të ofertave për privatizimin e shoqërisë anonime “Albtelecom”, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Miratimin e shoqërisë “Calik Enerji Telekomunikasyon A.S” si fituese për blerjen e 76 për qind të aksioneve të shoqërisë anonime “Albtelecom”, me vlerë 120 000 000 (njëqind e njëzet milionë) euro.
 3. Forma dhe mënyra e pagesës të jetë “Cash”.
 4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë të fillojë negocimin e kontratës me shoqërinë fituese.
 5. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë për nënshkrimin e kontratës me shoqërinë fituese.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano